

# Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara



*Empowered lives.  
Resilient nations.*

---

## Pyetje të shpeshta në eTenderim

Botimi Nr. 4

qershor 2016

## PËRMBAJTJA

1. Nuk mund të kyçem në eTenderim duke përdorur llogarinë event.guest. Thotë se nuk e njeh emrin e përdoruesit ose fjalëkalimin.....3
2. Kam marrë emailin e konfirmimit të regjistrimit, por dështova të kyçem në sistem. Thotë se nuk e njeh emrin e përdoruesit ose fjalëkalimin.....3
3. Kam krijuar një profil të ofertuesit për eTenderimin e UNFPA-së. A mund ta përdor për qasje në tenderët e UNDP-së?.....3
4. Ku mund ta shkarkoj Udhëzuesin e trajnimit të ofertuesve në eTenderim?.....3
5. Jam kyçur në sistem por nuk shoh asnjë tender.....3
6. Si mund të kërkoj për tenderë të hapur nga një shtet specifik?.....3
7. Çka mund të shënoj si ID të përdoruesit gjatë regjistrimit?.....3
8. A mund ta ndryshoj adresën time si ofertues në profilin tim në sistem?.....4
9. A mund t'i ndryshoj detajet e kontaktit në profilin tim?.....4
10. Nuk jam i sigurt a jam i interesuar të dorëzoj ofertë. Fillimisht dua të shoh kërkesat e tenderit. Si mund ta bëjë këtë?.....4
11. Nuk mund ta shkarkoj një skedar të tenderit. Çka duhet të bëj?.....4
12. E refuzova ftesën në sistem, por tani jam i interesuar të marr pjesë. A mund ta bëj ende?.....4
13. E pranova ftesën, por nuk jam më i interesuar të dorëzoj ofertë. A mund ta anuloj pjesëmarrjen time?.....4
14. A mund ta ruaj një ofertë që ta përfundoj dhe ta dorëzoj më vonë?.....4
15. A mund ta përfundoj ofertën offline?.....4
16. E dorëzova një ofertë. Si të sigurohem se oferta është marrë?.....5
17. A do të marr njoftime automatike me email nëse ka ndryshime në tender?.....5
18. Kam një pyetje në lidhje me një tender specifik të hapur në sistemin e eTenderimit. Kë duhet të kontaktoj nga UNDP-ja?.....5
19. Kam dëgjuar se UNDP-ja ka hapur një tender, por nuk po e gjej në sistemin e eTenderimit.....5
20. Nuk po mund ta ngarkoj një dokument. Më jep një gabim që nuk e kuptoj.....5
21. Sistemi është i ngadaltë dhe nuk reagon mirë. Çka mund të bëj?.....5
22. Si t'i ngarkoj dokumentet e lidhura me ofertën time?.....6
23. U jam përgjigjur të gjithë faktorëve të ofertës dhe artikujve, por sistemi nuk më lejon ta dorëzoj ofertën time. Çka mund të bëj?.....6
24. Si mund ta ndryshoj ofertën time.....6
25. E kam dorëzuar një ofertë, por nuk dua të marr pjesë. Çka të bëj?.....6
26. E kam dorëzuar një ofertë dhe kam marrë konfirmimin me email, por dua të sigurohem që kam ofruar të gjitha informatat e kërkuara dhe se oferta ime është e plotë. Si mund ta bëjë këtë?.....6

**1. Nuk mund të kyçem në eTenderim duke përdorur llogarinë event.guest. Thotë se nuk e njeh emrin e përdoruesit ose fjalëkalimin.**

Fshni cache-në (historikun) e shfletuesit tuaj dhe provoni sërish. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni pikën e fokusit të listuar në prokurim.

**2. Kam marrë emailin e konfirmimit të regjistrimit, por dështova të kyçem në sistem. Thotë se nuk e njeh emrin e përdoruesit ose fjalëkalimin.**

Ju lutemi provoni opsionet e mëposhtme:

- Prisni rreth 1 orë nga momenti që merrni konfirmimin me email dhe pastaj provoni sërish.
- Fshni cache-në (historikun) e shfletuesit tuaj dhe provoni sërish.
- Ju lutemi sigurohuni që po përdorni <https://etendering.partneragencies.org>. Mos klikoni në lidhjen e përfshirë në emailin e konfirmimit.
- Fjalëkalimin shtypeni manualisht. Mos e kopjoni dhe ta ngjisni.

Nëse problemi vazhdon, kontaktoni pikën e fokusit të listuar në prokurim.

**3. Kam krijuar një profil të ofertuesit për eTenderimin e UNFPA-së. A mund ta përdor për qasje në tenderët e UNDP-së?**

Jo, duhet të krijoni një profil të veçantë të ofertuesit për qasje në tenderët e UNDP-së. Do të mundeni vetëm të shihni për agjencinë përmes së cilës jeni kyçur.

**4. Ku mund ta shkarkoj Udhëzuesin e trajnimit të ofertuesve në eTenderim?**

Doracakun e udhëzimeve mund ta shkarkoni në secilin prej burimeve të mëposhtme:

- Në sistemin e eTenderimit. Doracaku i udhëzimeve është ngarkuar në tendert dhe është i disponueshëm duke klikuar në *Shiko Dokumentet e Tenderit*.
- Njoftimi i prokurimit i publikuar në uebfaqen e UNDP-së për secilin nga tenderët e kryer me sistemin e eTenderimit.
- Në uebfaqen e njoftimeve të prokurimit të UNDP-së <http://procurement-notices.undp.org/> bashkë me informatat e përgjithshme të sistemit dhe video udhëzimet.

**5. Jam kyçur në sistem por nuk shoh asnjë tender.**

Sigurohuni që Tenderi dhe Kërkesa për Informata të jenë të zgjedhura në çdo seksion të kriteve të kërkimit dhe pastaj kërkoni sërish. Referojuni pjesës 4.1 të Udhëzuesit të trajnimit të ofertuesve.

**6. Si mund të kërkoj për tenderë të hapur nga një shtet specifik?**

Në seksionin e kriteve të kërkimit, në rubrikën EventID, fusni kodin e shtetit në kutinë e parë. Nëse nuk jeni të sigurt për kodin e shtetit specifik që po kërkoni, referojuni pjesës 9, shtojcës II të Udhëzuesit të trajnimit të ofertuesve.

**7. Çka mund të shënoj si ID të përdoruesit gjatë regjistrimit?**

ID e përdoruesit duhet të jepet në formatin vijues: emri.mbiemri. Është shumë e

rekomanduar që ID e përdoruesit të përfaqësojë kompaninë dhe jo individin.

**8. A mund ta ndryshoj adresën time si ofertues në profilin tim në sistem?**

Po, mund ta ndryshoni adresën duke shkuar në *Menaxho tenderin dhe paraqit ofertë*→*Profili im i ofertimit* dhe klikoni në rubrikën Adresa. Referojuni pjesës 7.2 të Udhëzuesit të trajnimit të ofertuesve.

**9. A mund t'i ndryshoj detajet e kontaktit në profilin tim?**

Po, mund t'i ndryshoni detajet e kontaktit duke shkuar në *Menaxho tenderin dhe paraqit ofertë*→*Profili im i ofertimit* dhe klikoni në rubrikën Kontakte. Këtu mund të ndryshoni informatat e detajeve të kontaktit si emri, adresa email, numri i telefonit etj., për të gjithë kontaktet e regjistruar në profilin tuaj. Referojuni pjesës 7.2 të Udhëzuesit të trajnimit të ofertuesve për më shumë informata.

**10. Nuk jam i sigurt a jam i interesuar të dorëzoj ofertë. Fillimisht dua të shoh kërkesat e tenderit. Si mund ta bëjë këtë?**

Klikoni në Shiko dokumentet e ofertimit në faqen e parë të tenderit. Do të shfaqë një listë me dokumente të bashkëngjitura. Dokumenti i titulluar Detajet e tenderit është dokument i konsoliduar i kërkesave të tenderit në format PDF. Edhe dokumentet e tjera të përfshira në tender janë të disponueshme. Referojuni pjesës 4.2 të Udhëzuesit të trajnimit të ofertuesve për më shumë informata.

**11. Nuk mund ta shkarkoj një skedar të tenderit. Çka duhet të bëj?**

Sigurohuni që i keni lejuar dritaret popo-up në shfletues. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni pikën e fokusit të tenderit për asistencë.

**12. E refuzova ftesën në sistem, por tani jam i interesuar të marr pjesë. A mund ta bëj ende?**

Po, mund të dorëzoni ende një ofertë, me kusht që të jetë brenda afatit përfundimtar.

**13. E pranova ftesën, por nuk jam më i interesuar të dorëzoj ofertë. A mund ta anuloj pjesëmarrjen time?**

Po, nëse nuk keni dorëzuar ofertë thjesht mos e dorëzoni. Nëse e keni dorëzuar tashmë një ofertë, anuloheni nga sistemi. Pranimi i ftesës nuk e detyron ofertuesin të dorëzojë ofertë. Sidoqoftë, ju lutemi të kini parasysh se nëse e refuzoni ftesën nuk do të merrni sinjalizime nga sistemi për tenderin përkatës.

**14. A mund ta ruaj një ofertë që ta përfundoj dhe ta dorëzoj më vonë?**

Po, por **duhet të jeni të vetëdijshëm se një ofertë e ruajtur nuk dorëzohet pa klikuar në Dorëzo ofertën**. Është përgjegjësi e ofertuesit të sigurohet që oferta e tyre është me status “e postuar” para përfundimit të afatit të tenderit.

**15. A mund ta përfundoj ofertën offline?**

Po. Fillimisht duhet të shkarkoni dokumentet e tenderit si skedar.xml dhe ta përfundoni

ofertën në Excel. Sidoqoftë, skedarët e bashkëngjitur duhet të ngarkohen direkt dhe online në sistem. Referojuni pjesës 5.6 të Udhëzuesit të trajnimit të ofertuesve për më shumë informata.

**16. E dorëzova një ofertë. Si të sigurohem se oferta është marrë?**

Një konfirmim me email dërgohet në adresën email të llogarisë suaj në sistem, bashkë me një kopje të ofertës suaj. Shikoni dokumentet e bashkëngjitura dhe sigurohuni që të të gjitha përgjigjet të jenë të sakta dhe dokumentet e bashkëngjitura të jenë të dukshme.

Për t'u siguruar plotësisht se e keni dorëzuar me sukses ofertën tuaj, duhet të kyçeni në eTenderim dhe të shikoni ofertat e dorëzuara dhe të regjistruara në sistem dhe të siguroheni se janë me status të Postuar në tenderin përkatës. Referojuni pjesës 6.1 të Udhëzuesit të trajnimit të ofertuesve për më shumë informata.

**17. A do të marr njoftime automatike me email nëse ka ndryshime ne tender?**

Vetëm ofertuesit që 1) kanë pranuar ftesën në tender në sistem, 2) janë ftuar direkt nga UNDP=ka, ose 3) kanë dorëzuar ofertë për versionin origjinal të tenderit, do të marrin njoftime automatike për ndryshimet. Të tjerët do të mundën t'i shohin ndryshimet e bëra në sistem për një tender të caktuar, por nuk do të marrin njoftime me email. Referojuni pjesës 6.4 të Udhëzuesit të trajnimit të ofertuesve për më shumë informata.

**18. Kam një pyetje në lidhje me një tender specifik të hapur në sistemin e eTenderimit. Kë duhet të kontaktoj nga UNDP-ja?**

Pika e fokusit për çdo tender në eTenderim tregohet në tenderin korrespondues në sistem. Përveç kësaj, pika e fokusit përmendet në dokumentin e bashkëngjitur e titulluar detajet e tenderit, si dhe gjenden në dokumentin e kërkesës.

**19. Kam dëgjuar se UNDP-ja ka hapur një tender, por nuk po e gjej në sistemin e eTenderimit.**

Nëse është hapur një tender nga UNDP-ja dhe nuk e gjeni në sistem, kjo mund të ndodhë sepse:

- Procesi i tenderimit nuk kryhet në sistemin e eTenderimit.
- Tenderi nuk bazohet në proces të hapur ofertimi, çka nënkupton se dokumentet e tenderit u dërgohen vetëm furnizuesve të përzgjedhur.

Kontaktoni zyrën përkatëse të UNDP-së për më shumë informata.

**20. Nuk po mund ta ngarkoj një dokument. Më jep një gabim që nuk e kuptoj.**

Sigurohuni që emri i skedarit është vetëm me alfabet latin dhe përbëhet nga maksimumi 60 karaktere. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni pikën e fokusit të tenderit.

**21. Sistemi është i ngadaltë dhe nuk reagon mirë. Çka mund të bëj?**

Përpiquni të shkyçeni dhe pastaj kyçuni sërish dhe fshini historikun e shfletimit.

Përveç kësaj, përpquni të përdorni një shfletues tjetër.

**22. Si t'i ngarkoj dokumentet e lidhura me ofertën time?**

Ngarkojini dokumentet në rubrikën Shiko/Shto Komente të Përgjithshme dhe Dokumente të Bashkëngjitura në krye të tenderit. Referojuni pjesës 5.3 të Udhëzuesit të trajnimit të ofertuesve për më shumë informata.

**23. U jam përgjigjur të gjithë faktorëve të ofertës dhe artikujve, por sistemi nuk më lejon ta dorëzoj ofertën time. Çka mund të bëj?**

Sigurohuni se u jeni përgjigjur saktë të gjithë faktorëve të ofertës të shënuar me Kërkohet Përgjigje Ideale. Nëse jo, sistemi nuk do ta lejojë dorëzimin e ofertës. Shtypni Valido Të dhënat dhe lexo mesazhet e gabimeve që shfaqen në krye të faqes. Nëse nuk ka mesazhe gabimesh, përpquni ta dorëzoni ofertën sërish. Referojuni pjesve 5.1 dhe 5.4 të Udhëzuesit të trajnimit të ofertuesve për më shumë informata.

**24. Si mund ta ndryshoj ofertën time?**

Për të modifikuar ofertën, klikoni në Shiko, Ndrysho dhe Kopjo nga Ofertat e Ruajtura në faqen kryesore të tenderit. Shtypni Edit/Modifiko. Nëse e keni shtypur Edit është me rëndësi që të klikoni Dorëzo ofertën për t'u siguruar se oferta është postuar në sistem. **Nëse e modifikoni ofertën dhe klikoni në Ruaje për më vonë, do të tërhiqeni edhe nga oferta origjinale.** Referojuni pjesës 6.2 të Udhëzuesit të trajnimit të ofertuesve për më shumë informata.

**25. E kam dorëzuar një ofertë, por nuk dua të marr pjesë. Çka të bëj?**

Mund ta anuloni ofertën tuaj duke shkuar në Shiko, Ndrysho dhe Kopjo nga Ofertat e Ruajtura në faqen kryesore të tenderit, dhe pastaj shtypni Anulo. Referojuni pjesës 6.3 të Udhëzuesit të trajnimit të ofertuesve për më shumë informata.

**26. E kam dorëzuar një ofertë dhe kam marrë konfirmimin me email, por dua të sigurohem që kam ofruar të gjitha informatat e kërkuara dhe se oferta ime është e plotë. Si mund ta bëj këtë?**

Për të shikuar ofertën, klikoni në Shiko, Ndrysho dhe Kopjo nga Ofertat e Ruajtura në faqen kryesore të tenderit. Shtypni Shiko. Mund të shqyrtoni përgjigjet që keni ofruar, duke përfshirë çmimet dhe dokumentet e bashkëngjitura.